



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 135/3 Prot.

Tiranë më 14.02.2020

VENDIM

Nr. 02, datë 14.02.2020

PËR KONTROLLUESIN “KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Kolegji Universitar Qiriaz”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.11, datë 24.01.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 04.02.2020 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit “Kolegji Universitar Qiriaz” me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Kontrolluesi “Kolegji Universitar Qiriaz”, është institucion arsimor i lartë i akredituar në vitin 2016, në fushat e drejtësisë dhe ekonomisë. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, kontrolluesi “Kolegji Universitar Qiriaz”, mbledh të dhënat e studentëve, stafit akademik, stafit administrativ dhe vizitorë të ambienteve të kontrolluesit.

Nga hetimi administrativ i ushtruar në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore, Zyra e Komisionerit pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit “Kolegji Universitar Qiriaz”, konstaton se:

1. Kontrolluesi “Kolegji Universitar Qiriaz”, ka “Njoftuar” Zyrën e Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21 dhe 22, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Megjithatë, konstatohet se Formulari i Njoftimit është plotësuar në vitin 2010 dhe nga ky moment e në vijim, gjendja e kontrolluesit ka ndryshuar. Ndryshimi i gjendjes së

kontrolluesit duhet të reflektohet dhe në përditësimin e formularit në disa rubrika lidhur me pikat 1.1 të dhënat e subjektit kontrollues, 1.2 personi i kontaktit, 4.1 kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen, 6.1. qëllimi i përpunimit, 10.1 masat e sigurisë etj.

Përditësimi i "Njoftimit" mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është një detyrim ligjor i rëndësishëm pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

Mos kryerja e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "a" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar me punonjësit "Deklaratë Konfidencialiteti", në zbatim të nenit 28, ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 6/2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale". Në kontratat individuale të punës të nënshkruara me stafin akademik dhe administrativ gjenden dispozita që rregullojnë konfidencialitetin.
3. Konstatimi përbën shkelje të nenit 28, të ligjit nr.9887/2008, i cili parashikon se: *"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj"* si dhe Vendimit nr.6/2013 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të studentëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull "Deklaratë Konfidencialiteti", dalë në zbatim të Vendimit nr.06/2013, të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale", merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

4. Kontrolluesi ka hartuar rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale, sipas detyrimit të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar
5. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejsimi CCTV dhe informon nëpërmjet tabelave informuese për prezencën e këtij sistemi, në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010, të Komisionerit mbi *“Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejsimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.
6. Kontrolluesi ka vendosur një rubrikë të mirëfilltë për Politikën e Privatësisë në faqen zyrtare të internetit www.qirjazi.edu.al, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin, i cili është nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të kontrolluesit me pretendimin se mori dijeni për procesverbalin dhe do të merren masa për përmbushjen e konstatimeve brenda tre ditëve (brenda datës 07.02.2020).

Në datën 10.02.2020 ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet si më poshtë:

- Formular njoftimi të përditësuar sipas gjendjes aktuale të kontrolluesit;
- Model *“Deklarate Konfidencialiteti”*.

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, kontrolluesi *“Kolegji Universitar Qiriazhi”* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 11.02.2020, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit është paraqitur në seancën e caktuar dhe nuk ka paraqitur asnjë pretendim apo kundërshtim lidhur me konstatimet e procesverbalit të datës 04.02.2020.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ konsistojnë në mungesën e përditësimit të formularit të njoftimit si dhe mungesës së deklaratave të konfidencialitetit për stafin që ka akses në të dhëna personale.

Mos përmbushja e këtyre detyrimeve, në kuptim të gërmës *“d”* dhe *“dh”*, të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- d) *“Kontrolluesit që nuk përmbush detyrimin për të njoftuar sipas përcaktimit të nenit 21 të këtij ligji, dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë”;*
- dh) *“Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë”.*

Kontrolluesi "Kolegji Universitar Qiriazhi" në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, për kundërvajtjen e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara në lidhje me njoftimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave janë serioze. Rezulton nga të dhënat Formularit të Njoftimit se Kontrolluesi nuk ka reflektuar ndryshimet në rubrika thelbësore si: ndryshimi i Personit të kontaktit, ndryshimi i emërtesës së kontrolluesit, si dhe nuk ka marrë masat e përshtatshme për ruajtjen e konfidencialitetit. Megjithatë, është marrë në konsideratë edhe bashkëpunimi i treguar me grupin e kontrollit si dhe reagimi për rikuperimin e shkeljeve, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, gërmat, "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Kolegji Universitar Qiriazhi", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Kolegji Universitar Qiriazhi", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 dhe 28, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
3. Gjoka arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 14.02.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

